



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0038
Data e Vendimit: 01.01.0001

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) “BARDHI NDERTIM” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN”, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 25/01/2024, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e OE “BARDHI NDERTIM” SH.P.K me Nr. të protokollit 2024/0038, e datës 10/01/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”, me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN”.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues–“KUVENDI KOMUNAL- GJILAN” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”, me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 10/01/2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “BARDHI NDERTIM” SH.P.K, për aktivitetin e prokurimit me “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, inicuar nga “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN”, në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave me datën 12.01.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, ta plotësoj ankesën sipas nenit 111 të LPP në të kundërtën hedhet si e palejuar ankesa. Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së, OE ankues nuk ka kompletuar ankesën sipas kërkesës së institucionit.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “BARDHI NDERTIM” SH.P.K e datës 10.01.2024 (protokoll 0038/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit” me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN”, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazëduke e hedhur të njëjtën si palejuar- jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues “KUVENDI KOMUNAL- GJILAN” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Gjilanit”, me numër të prokurimit 651-23-13546-5-1-1, përkritazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë, OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me

nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kriteve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen *vetëm në kriteret e nevojshme* për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues **nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji.** Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60,65,69,70 të LPP.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - BARDHI NDERTIM SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: